

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
1.	16.01.2025	Shprehje interesi për të punuar pranë institucionit si specialiste juriste apo sekretare.	27.01.2025	Kërkuesi u informua se Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor nuk ka një pozicion të lirë pune për sa ka shprehur interes. Në rast vakance, mund të informohej në web-in zyrtar të institucionit, ndër të tjera edhe për kriteret që duhet të përmbushë aplikanti, dokumentet që duhet të depozitohen nga ana e tij etj., sipas njoftimit përkatës për pozicionin e punës.	E plotë	Nuk ka
2.	20.01.2025	Çmimi i biletave të koncertit "TRËNDAFILIN KUR TA DHASH".	20.01.2025	Në zbatim të VKM-së nr. 627, datë 29.07.2020 "Për miratimin e tarifës së biletave të TKOBAP-së", kërkuesja u informua si më poshtë për çmimin e biletave të koncertit "Trëndafilin kur ta dhash" në bazë të ulëseve: - Llozhat qendrore 1.000 lekë/copa - Platea 7-16 800 lekë/copa - Lozhat anësore 800 lekë/copa - Platea 1-6 500 lekë/copa - Galeria 500 lekë/copa.	E plotë	Nuk ka

3.	11.02.2025	Shprehje interesi për të punuar pranë institucionit si drejtor i Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë	14.02.2025	Kërkuesi u informua se Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor nuk ka shpallur pozicion të lirë pune për sa është shprehur interesi. Në rast vakance, iu bë me dije se mund të informohej në web-in zyrtar të institucionit, ndër të tjera edhe për kriteret që duhet të përmbushë aplikanti, dokumentet që duhet të depozitohen nga ana e tij etj., sipas njoftimit përkatës për pozicionin e punës. Kërkuesi u falënderua për shprehjen e interesit.	E plotë	Nuk ka
4.	26.03.2025	Kërkuesi kërkon një vërtetim për angazhimin e tij në disa prej shfaqjeve artistike të TKOBAP-së gjatë vitit kalendarik 2024	02.04.2025	Kërkuesi u informua se kërkesa për informim duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij si dhe duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit (bashkëlidhur dokumentin e identifikimit); b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; ç) formatin në të cilin preferohet informacioni; d) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar. Nëse dorëzimi do të bëhet me postë elektronike, kërkesa me përmbajtjen si më lart cituar duhet të depozitohet, pas nënshkrimit që përmban	E refuzuar deri në depozitim n e dokumentacionit të kërkuar	Nuk ka

				emrin, mbiemrin dhe firmën, e skanuar.		
5.	02.04.2025	Shprehje interesi për të punuar pranë institucionit sipas pozicioneve të punës në fushën “kanto”	07.04.2025	Kërkuesi u informua se në vijim të jetëshkrimit të depozituar nga ana e tij, aktualisht Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor nuk ka shpallur pozicione të lira pune në bazë të pikës 14 të VKM nr. 122, datë 26.2.2025 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025”, i cili parashikon se: “Institucionet dhe shoqëritë aksionare publike, pjesë e administratës shtetërore që punësojnë punonjës, marrëdhënia e punësimit së të cilëve rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës apo legjislacioni tjetër specifik, të ndryshëm nga ai i shërbimit civil, pezullojnë procedurat e rekrutimit dhe të emërimit të	E plotë	Nuk ka

				nëpunësve/punonjësve për periudhën 3 mars 2025–11 maj 2025...”. Në vijimësi iu bë e ditur se mund të informohej në web-in zyrtar të institucionit (www.tkob.gov.al-Njoftime), ndër të tjera edhe për kriteret që duhet të përmbushë aplikanti, dokumentet që duhet të depozitohen nga ana e tij etj., sipas njoftimeve përkatëse për pozicionet e punës që do të shpallen.		
6.	02.04.2025	Kërkesë për akses në bibliotekën e TKOBAP	07.04.2025	Kërkuesi u informua se kërkesa e depozituar me anë të postës elektronike nga ana e tij duhet të paraqesë saktë nënshkrimin (emrin, mbiemrin dhe firmën) dhe të depozitohet e skanuar duke bashkëlidhur edhe dokumentin e identifikimit me qëllim edhe plotësimin e dosjes së studiuësve pranë Bibliotekës Muzeore të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor. Në kërkesë të përcaktohet gjithashtu data dhe orari në të cilin do të paraqitej fillimisht me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm nga punonjësit pranë këtij sektori edhe për vijimësinë e konsultimit të dokumenteve për interesat e tij studimore.	E refuzuar deri në depozitimin e dokumentacionit të kërkuar	Nuk ka

7.	03.04.2025	Vijim i kërkesës me numër rendor 5	10.04.2025	Dokumentacioni u depozitua nga ana e kërkuarit dhe u pajis me vërtetimin e kërkuar.	E plotë	Nuk ka
8.	02.05.2025	Kërkesë për një kopje të Raportit Përfundimtar të Auditit të MEKI	05.05.2025	Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, kërkesa i është përcjellë institucionit kompetent për trajtim. Njëkohësisht kërkuarësi është informuar me shkresë të veçantë se kërkesa është përcjellë pranë grupit të auditimit të MEKI.	Deleguar	Nuk ka

9.	24.05.2025	Shprehje interesi për të punuar pranë institucionit si biletashitës	03.06.2025	Kërkuesi u informua se Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor nuk ka një pozicion të lirë pune për sa është shprehur interesi. Në rast vakance, iu bë me dije se mund të informohej në web-in zyrtar të institucionit, ndër të tjera edhe për kriteret që duhet të përmbushë aplikanti, dokumentet që duhet të depozitohen nga ana e tij etj., sipas njoftimit përkatës për pozicionin e punës. Kërkuesi u falënderua për shprehjen e interesit.	E plotë	Nuk ka
10.	26.06.2025	Depozitim dokumentash si shprehje interesi për të punuar pranë institucionit sipas pozicioneve të punës në fushën “kanto”	07.07.2025	Kërkuesi u informua se Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor nuk ka një pozicion të lirë pune për sa është shprehur interesi. Në rast vakance, iu bë me dije se mund të informohej në web-in zyrtar të institucionit, ndër të tjera edhe për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme që duhet të përmbushë aplikanti, programin artistik për konkurimin etj., sipas njoftimit/eve përkatëse për pozicionin/et e punës.		

11.	02.07.2025	Kërkuesi ka paraqitur kërkesën: “Unë jam duke e kërkuar versionin e plotë të këngës “Zare trëndafile” të kënduar nga Ilir Shaqiri, por fatkeqësisht nuk e kam gjetur askund te plotë. Pasi kontaktova me të lartpërmendurin, më tha që mund ta gjej te ju versionin e plotë të këngës. A e keni ju këngën e regjistruar, dhe nese po a mund të ma dërgoni? Do të jua dija për nder. Faleminderit paraprakisht! P.S. Për referencë po jua bashkëngjis vegëzën e këngës të cilën po e kërkoj: https://m.youtube.com/watch?v=ymhI24U21dw&pp=ygUiTW9qIFphcmUgdHJlbmRhZmlsZSAgaWxpciBzaGFxaXJpIA%3D%3D	04.07.2025	Kërkuesi u informua se versionin e këngës "Zare" të interpretuar nga z. Ilir Shaqiri e gjen të regjistruar në minutazhin 6:10-10:00 në linkun e publikuar nga Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor: https://youtu.be/G-rf3ATwuhY?si=51NpxeFcf0M0KS02	E plotë	Nuk ka
-----	------------	--	------------	---	---------	--------

12.	07.07.2025	Informacion për lejen e pakryer vjetore për vitin 2023	09.07.2025	Ish-punonjësi u informua pas verifikimeve të kryera në listëprezencat e TKOBAP-së për pushimet vjetore të paguara të pakryera nga e tij për vitin 2023	E plotë	Nuk ka
13.	28.08.2025	Shprehje interesi për të punuar pranë institucionit si fotograf	09.09.2025	Kërkuesi u informua se Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor nuk ka një pozicion të lirë pune për sa është shprehur interesi. Në rast vakance, iu bë me dije se mund të informohej në web-in zyrtar të institucionit, ndër të tjera edhe për kriteret që duhet të përmbushë aplikanti, dokumentet që duhet të depozitohen nga ana e tij etj., sipas njoftimit përkatës për pozicionin e punës. Kërkuesi u falënderua për shprehjen e interesit dhe punimet e depozituara.	E plotë	Nuk ka
14.	Nuk ka kërkesa të depozituara për informim për muajin shtator 2025					
15.	Nuk ka kërkesa të depozituara për informim për muajin tetor 2025					
16.	Nuk ka kërkesa të depozituara për informim për muajin nëntor 2025					